

## VENDIM

Nr. 734, datë 28.8.2013

### **PËR KRIJIMIN E SISTEMIT UNIK TË REGJISTRIMIT, AUTENTIFIKIMIT DHE IDENTIFIKIMIT TË PËRDORUESVE NË MARRJEN E SHËRBIMEVE PUBLIKE NGA SISTEMET ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 10 të ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Marrja e shërbimeve publike të qeverisjes elektronike nëpërmjet portalit qeveritar dhe/ose sistemeve të tjera elektronike nga çdo përdorues, person fizik ose juridik, kalon në procesin e autentifikimit dhe identifikimit për garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në ofrimin e shërbimeve individuale.
2. Procesi i autentifikimit dhe i identifikimit në sistemet e qeverisjes elektronike bazohet në strategjinë "Single-Sign-On", për krijimin e një identiteti unik për çdo përdorues. Autentifikimi dhe identifikimi në portalin qeveritar dhe/ose sisteme të tjera elektronike realizohet nëpërmjet sistemit të ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore, që koordinohet, zhvillohet dhe administrohet nga Autoriteti Rregullator Koordinues (ARK) i bazave të të dhënave shtetërore.
3. Procesi i regjistrimit kryhet nëpërmjet portalit qeveritar dhe të dhënat e plotësuara nga përdoruesit, gjatë procesit të regjistrimit, verifikohen elektronikisht me të dhënat e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile për individët dhe Regjistrimit Kombëtar Tregtar për bizneset (QKR).
4. Të dhënat personale të përdorura gjatë regjistrimit të përdoruesve në sistemin unik të autentifikimit dhe të identifikimit trajtohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Institucionet që janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e teknologjisë së informacionit, për të cilat është i nevojshëm autentifikimi dhe identifikimi i përdoruesve, duhet ta realizojnë këtë nëpërmjet Sistemit Unik të Identifikimit.
6. Institucionet, të cilat kanë sisteme ekzistuese në fushën e teknologjisë së informacionit, për të cilat është i nevojshëm autentifikimi dhe identifikimi i përdoruesve dhe të cilat përdorin mekanizma të tjerë të autentifikimit e identifikimit duhet të përshtatin sistemet e tyre për të përdorur Sistemin Unik të Identifikimit deri në datën 31 dhjetor 2015.
7. Specifikimet teknike të ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore për regjistrimin dhe autentifikimin përcaktohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues (ARK) dhe botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.

8. Ngarkohet Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Autoriteti Rregullator Koordinues i bazave të të dhënave shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha